



## FJALË PËRSHËNDETËSE

*Erik Berglof\**

*Shumë faleminderit, Piroška!*

Pa dashur të marr shumë nga koha juaj, më lejoni t'ju them se ne e kemi ndjekur me shumë vëmendje ecurinë e ngjarjeve në Shqipëri, dhe sigurisht ato që kanë ndodhur nga viti i kaluar. Ju jeni përballur me shumë vështirësi, ndaj ju urojmë më të mirat!

Teksa shihja fotot e konferencës së vitit të shkuar, më erdhën në mendje shumë kujtime të këndshme, si dhe kujtime të diskutimeve mjaft interesante. Atëherë nuk e dinim se çfarë na priste vitin që do të vinte. Dhe ç'është e vërteta, ju u goditët njëkohësisht nga një tërmet dhe shumë gjëra të tjera.

Njeriu bëhet më i përlur kur përjeton të tilla ngjarje, të cilat na mësojnë se njohuritë tona rreth ekonomisë dhe, në këtë rast, rreth ndërveprimit mes ekonomisë dhe një urgjence mjekësore, janë të kufizuara. Na është ofruar një mundësi për të mësuar nga kjo përvojë dhe për ta parë atë nga këndvështrimi i Shqipërisë dhe i Evropës Juglindore. Jam i sigurt se do të përfshihemi në diskutime interesante njësoj si vitin e shkuar dhe shpreh entuziazmin tim për këtë konferencë.

---

\* *Erik Berglof, LSE & Kryeekonomist, Banka Aziatike e Investimeve Infrastrukturore (AIIB)*

Përshkrimi i situatës që na ofroi ministria e financave, përfaqëson shumë ekonomi në zhvillim, që kanë pasur një ecuri relativisht të mirë teksa janë përballur me presionin e jashtëzakonshëm të pandemisë. Ato kanë përfituar nga ndikimet e zgjerimit të stërmadh që u ndërmor nga bankat qendrore me rëndësi sistemike. Megjithatë rezistenca e tyre reflekton edhe përvojat e gjata dhe shumë vite pune të rëndësishme, për të ndërtuar institucione më të qëndrueshme dhe për të formuar politika më të forta dhe më reaguese në shumë ekonomi në zhvillim. Kam pasur kënaqësinë ta ndjek këtë proces në Shqipëri dhe është mbresëlënëse kur shoh se si ministria e financave dhe banka qendrore janë përforcuar gradualisht si institucione.

Do të vijojmë me diskutimet tona, duke ju falënderuar sërish që më ftuat! Kjo traditë dhe ky bashkëpunim janë mjaft të rëndësishëm, ndaj jam entuziast për vijueshmërinë e punimeve të kësaj konference.

Faleminderit!